

BASHKIA TIRANË

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia e Tiranës
Adresa Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tel/Fax 00 355 4 22 56 799
E-mail infrastruktura.prokurime@tirana.al
Ueb-faqe www.tirana.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”

3. Numri i referencës së procedurës/ Lotit (eve): REF-35724-01-22-2025

Numri i referencës së lotit I: REF- 35728-01-22-2025

Numri i referencës së lotit II: REF-35731-01-22-2025

Numri i referencës së lotit III: REF-35733-01-22-2025

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Mbikqyrja e punimeve për 3 objekte publike për vitin 2024”, të ndarë në lote si më poshtë vijon:

Loti I: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtim Shkollë 9 vjecare Tipi (2) dhe e mesme Tipi (4) , Njësia Strukturore KA 283, Rruga “3 Dëshmorët”.

Loti II: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtim i palestrës dhe ambienteve shtesë në shkollën 9 – vjecare “Avni Rustemin”.

Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Instalacioni Tirana Mooons”.

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 71247000-1 Mbikqyrja e punës së ndërtimit.

6. Fondi limit: **8,376,587.39**, (tetë milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024, miratuar me VKB Nr.116, datë 08.10.2024 dhe VKB Nr. 69, datë 27.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr. 125, datë 22.12.2023, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024” (i ndryshuar), të ndarë në lote si më poshtë vijon:

Loti I: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtim Shkollë 9 vjecare Tipi (2) dhe e mesme Tipi (4) , Njësia Strukturore KA 283, Rruga “3 Dëshmorët” me fond limit: **6,944,612.33** (gjashtë milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Loti II: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtim i palestrës dhe ambienteve shtesë në shkollën 9 – vjecare “Avni Rustemin” me fond limit: **848,599.20** (tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë njëzet) lekë pa tvsh.

Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Instalacioni Tirana Mooons” me fond limit: **583,375.86** (pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:

- **Loti I:** Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtim Shkollë 9 vjecare Tipi (2) dhe e mesme Tipi (4) , Njësia Strukturore KA 283, Rruga “3 Dëshmorët”, 24 (njëzet e katër) muaj kalendarik.
- **Loti II:** Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtim i palestrës dhe ambienteve shtesë në shkollën 9 – vjecare “Avni Rustemin”, 5 (pesë) muaj kalendarik.
- **Loti III:** Mbikqyrja e punimeve për objektin “Instalacioni Tirana Mooons”, 6 (gjashtë) muaj kalendarik.

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 07 / 02/ 2025, Ora: 10:00

9. Procedurë e Rishpallur:

Po

Jo

X